

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI JURIDIK**

**STUDIMET POSTDIPLOMIKE - MASTER**

**DREJTIMI PENAL**



**PUNIM MASTERI**

**“Fenomenologjia dhe etiologjia e dhunës në familje në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega Lipjan gjatë periudhës kohore 2016-2021”**

**Mentore:**

**Prof.Dr Flutura Tahiraj**

**Kandidate:**

**Vesa Bajrami**

Prishtinë, 2023

## ABSTRAKT

Fenomeni i dhunës në familje si dukuri majft shqetësuese është shumë i pranishëm si në botë edhe në familjet kosovare. Trajtimi i kësaj dukurie ka rëndësi të madhe për shkak të pasojave negative që shkakton tek viktima, pasojave në familje e në përgjithësi në shoqëri. Studimi i fenomenologjisë dhe etiologjisë së dhunës në familje në përgjithësi na ndihmon të kuptojmë më shumë vëllimin, strukturën, dinamikën dhe faktoret me ndikim në paraqitjen e aktve të dhunës në familje. Numri i rasteve të dhunës në familje po shënon rritje të vazhdueshme në Kosovë, andaj qëllimi kryesor i këtij punimi është të njihemi me fenomenologjinë dhe etiologjinë e dhunës në familje me theks të vecantë në komunën e Lipjanit duke u bazuar në praktikën e Gjykatën Themelore në Prishtinë- dega në Lipjan për vitet 2016-2021. Në Gjykatën në Lipjan më saktësisht në arkivën e saj janë mbledhurat dhëna për numrin elëndëve penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje karakteristikat dhe veçoritë e kryesve të veprave penale të dhunës në familje dhe shkaqet të cilat kanë ndikuar në paraqitjen e dhunës në familje për periudhën 2016-2021. Gjatë kësaj periudhe në këtë gjykatë janë gjykuar në total 120 persona të cilët janë dënuar me aktgjykim të plotëfuqishëm, ndërsa asnjë prej tyre nuk është liruar dhe nuk është shpallur i pafajshëm.

Fjalët kyçe: *dhuna në familje, fenomenologjia, etiologjia, ligjet, aktet ndërkombëtare, gjykata .*